



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

RAPORT I VEÇANTE

**Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit
LGBTI në Shqipëri**

PËRMBAJTJA

Hyrja	fq. 3
1. Kuadri Ligjor.....	fq.4
1.1Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.....	fq.4
1.2Legjislacioni shqiptar mbi të drejtat e komunitetit LGBTI.....	fq.6
2. Konteksti social, perceptimet dhe qëndrimet ndaj komunitetit LGBT.....	fq.9
II.2.1 Mbrojtja nga veprimet e dhunshme ndaj komunitetit LGBTI.....	fq.10
II.2.2. E drejta e organizimit, grumbullimit dhe liria e shprehjes.....	fq.11
II.2.3. Identiteti gjinor dhe jeta familjare.....	fq.13
II.2.4. Aksesit në kujdesin shëndetësor, edukim dhe punësim.....	fq.13
3. Adresimi i çështjeve të diskriminimit me synim rritjen e numrit të ankesave.....	fq.16
4. Hartimi i politikave dhe strategjive dhe adresimi i tyre nga institucioni i barazisë dhe mosdiskriminimit.....	fq.19
5. Promovimi i të drejtave të komunitetit dhe aspekti komunikativ.....	fq. 19
5.1 Media.....	fq.19
5.2. Organizimi i Konferencave dhe trajnimeve nga KMD dhe pjesëmarrja në seminare e tryeza diskutimi.....	fq.20
5.3. Publikimi i raporteve të veçanta, realizimi i monitorimeve dhe situatës.....	fq.22
5.4. Monitorimi në Arsim.....	fq.23
5.5. Botimi dhe shpërndarja e broshurave informuese dhe manualeve trajnuese.....	fq.24
Rekomandime	fq. 25
ANEKS.....	fq.28

Hyrja

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të komunitetit LGBT ka në themel një parim të rëndësishëm që ka të bëjë me pranimin se LGBT gëzojnë të njëjtat të drejta si çdo person tjetër për mosdiskriminim dhe ushtrim të të drejtave njerëzore¹. Respektimi i të drejtave të këtij komuniteti ka qenë vazhdimisht pjesë e detyrimeve të Shqipërisë gjatë procesit të integritetit evropian. “Forcimi i mbrojtjes së personave gej, lesbike, biseksuale dhe transgjendër” ka qenë pjesë e Planit të Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe është pjesë e Planit të Veprimit për adresimin e 5 prioriteteve.

Orientimi seksual përshkruan një model/strukturë të qëndrueshme tërheqjeje emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim të tyre kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja sekseve ose asnjërit prej sekseve dhe gjinive që i shoqërojnë ato². Identiteti gjinor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh femër ose mashkull, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik³. Për të kuptuar konceptin e identitetit gjinor është e rëndësishme të bëjmë dallimin midis koncepteve “seks” dhe “gjin”. Ndërsa koncepti i “seksit” na referon tek dallimi biologjik mes gruas dhe burrit, koncepti “gjendër” përfshin edhe aspektin social të dallimit midis gjinive, përtej atij biologjik⁴.

Shqipëria tashmë ka hartuar një legjislacion në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe ka krijuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit LGBT. Duke u bashkuar me shqetësimin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës përse i takon krijimit të institucioneve kombëtare të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe përcaktimit të një mandati të qartë për shqyrtimin e ankesave që vijnë nga ky komunitet, mund të themi se ligjvënësi shqiptar e ka tejkaluar këtë vështirësi. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucioni, i cili “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin” (neni 21, pika 1). Ky institucion ka kompetenca jo vetëm “të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin” (neni 32, pika f), por edhe “të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji” (neni 32, pika ç). Komisioneri garanton mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese në tre fusha kryesore: arsim, punësim dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

¹ Council of the European Union: “Toolkit to promote and protect the enjoyment of all human rights by lesbian, gay, bisexual and transgender (LGBT) people”, pg 3.

SHIH: http://www.hrea.org/erc/Library/display_doc.php?url=http%3A%2F%2Fwww.consilium.europa.eu%2Fuedocs%2FcmsUpload%2Fst11179.en10.pdf&external=N

² The Yogyakarta Principles, Principles on the Application of International Human Rights Law in Relation to Sexual Orientation and Gender Identity, adopted by a group of 29 human rights experts in November 2006 in Yogyakarta, Indonesia. Përkufizim sipas raportuesit Gross për rezolutën e KiE “Për diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

³ Përkufizim sipas raportuesit Gross për rezolutën e KiE “Për diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

⁴ Commissioner for Human Rights “Human Rights And Gender Identity”, Strasbourg, July 2009, fq 5.
Shih: www.commissioner.coe.int

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ushtron funksionet dhe kompetencat e tij në përputhje me Ligjin 10 221 për “Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë në përputhje me Direktivën 2006/54/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, i cili në nenin 20 parashikon se këto organe duhet të :

1. Sigurojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit përmes trajtimit të çështjeve apo asistencës në gjykatë;
2. Kryejnë sondazhe dhe monitorime të pavarura në lidhje me diskriminimin;
3. Publikojnë raporte dhe ofrojnë rekomandime edhe legjislative për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Organet Europiane të Barazisë dhe Mosdiskriminimit kanë përcaktuar disa aspekte që duhet të mbajnë parasysh gjatë trajtimit dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të komunitetit LGBTI⁵:

1. Kuadri ligjor.
2. Konteksti social, perceptimet dhe qëndrimet ndaj komunitetit LGBT.
3. Adresimi i çështjeve të diskriminimit me synim rritjen e numrit të ankesave.
4. Hartimi i politikave dhe strategjive dhe adresimi i tyre nga institucioni i barazisë dhe mosdiskriminimit.
5. Promovimi i të drejtave të komunitetit dhe aspekti komunikativ.

Pikërisht këto do të jenë edhe aspektet që do të trajtohen në këtë raport

1. Kuadri ligjor.

1.1. Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Në nenin 116, pika 2 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon si akte normative që për nga fuqia juridike vijnë menjëherë pas Kushtetutës aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Kjo jep mundësinë që ne t'i referohemi dokumentave të rëndësishme ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1948. Kjo deklaratë ka proklamuar parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit në një dispozitë të vetme (neni 7) që parashikon se “Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) i miratuar më 16 dhjetor 1966 me rezolutën 2200A (XXI) të Asamblesë së Përgjithshme, në Nenin 26 thekson se: “...ligji duhet

⁵ European Network of Equality Bodies “Equality bodies promoting equality & non-discrimination for LGBTI people”, Brussels 2013.

*të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, **seksit**, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, **lindjes** ose çdo situatë tjetër”.*

Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 1994. Ndërsa Protokollin Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2003. Është Komiteti për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i cili ka përcaktuar se diskriminimi i gruas për shkak të seksit dhe gjinisë është i lidhur me shkaqe të tjera ndër të cilat edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor⁶.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 1992. Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve në Komentin e Përgjithshëm Nr. 4 ka parashikuar shprehimisht orientimin seksual si shkak për të cilin ofrohet mbrojtja e fëmijëve në kuadër të kësaj Konvente.

Reporterë Specialë të Kombeve të Bashkuara kanë shprehur shqetësimin për situatën e komunitetit LGBTI. Deklarata e OKB-së mbi “Orientimin seksual dhe identitetin gjinor” nënshkruar nga vendi ynë më 18 dhjetor 2008.

Konventën nr.111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.

Deklarata e Montrealit “Mbi të drejtat e njeriut të Lesbikëve, Gejve, Biseksualëve dhe Transeksualëve” ku deklarohet njohja e të drejtave të komunitetit LGBTI në shëndetësi, arsim dhe emigracion. Deklarata gjithashtu adreson çështjet e ndryshme që kërcënojnë promovimin global të të drejtave të LGBTI⁷.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1996. Neni 14 i KEDNJ, Protokollin Nr. 12 i KEDNJ-së dhe Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbështesin të drejtën për të mos u diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, pavarësisht se ky i fundit shpesh nënkuptohet nga termi “seksit”.

Konventa e Këshillit të Europës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave dhe Dhunës Në Familje", është ratifikuar me ligjin Nr. 104/2012. Konventa ka si qëllim edhe

⁶ Commissioner for Human Rights: “Discrimination on grounds of sexual orientation and gender identity in Europe”, fq 36. Në këtë botim i referohen Rekomandimit Nr. 28 të këtij Komiteti.

⁷ Kjo Deklaratë është produkt i Konferencës Ndërkombëtare mbi të drejtat e komunitetit LGBTI, në Lojërat e para Botërore, 29 Korrik 2006.

*kontributin ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimin e barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave*⁸.

Karta Sociale Evropiane ka sanksionuar parimin e barazisë (neni 20) duke përcaktuar në mënyrë të shprehur se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe parimin e mosdiskriminimit (neni 21). Karta Sociale Evropiane, e Rishikuar, e nënshkruar më 1998 është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2002.

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të së drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre.

1.2. Legjislacioni shqiptar mbi të drejtat e komunitetit LGBT

Legjislacioni shqiptar ofron një mbrojtje të përgjithshme të të drejtave themelore të njeriut dhe në mënyrë specifike edhe të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Kushtetuta e RSH-së në disa dispozita të saj ka synuar nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit (kryesisht neni 18, por edhe nenet 16 e 20), ndërkohë që si kufirin e kufizimit të të drejtave të njeriut ka parashikuar pikërisht KEDNJ⁹. ***Kushtetuta nuk e parashikon shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si shkak të diskriminimit. Në një kuptim më të zgjertuar identiteti gjinor mund të nënkuptohet në termin “seksit”.***

Miratimi i ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për komunitetin LGBT përbën një hap pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të tyre¹⁰. ***Ky ligj përmban një listë jo shteruese shkaqesh për të cilat ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese, dhe parashikon shprehimisht mes tyre edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor***¹¹. Gjithashtu ligji jep

⁸ Konventa e Këshillit të Europës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave dhe Dhunës Në Familje", hyri në fuqi me 1 Gusht 2014.

⁹ Në nenin 18 Kushtetuta parashikon: 1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjeje e arsyeshme dhe objektive.

¹⁰ Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në përputhje me Direktivat e BE në fushën e mosdiskriminimit, ku përfshihen: Direktiva e Këshillit Europian 2004/43/KE e 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike". Direktiva e Këshillit Europian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës". Direktiva e Këshillit Europian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime". Direktiva e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Europian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

¹¹ Neni 1 i ligjit përcakton se qëllimi i tij është “ **zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual**, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

përkufizimet e një sërë konceptesh të rëndësishme si diskriminim i drejtpërdrejtë, diskriminim i tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, viktimizim, shqetësim.

Kodi i Punës i RSH-së¹² **nuk i parashikon në mënyrë të shprehur orientimin seksual dhe identitetin gjinor si shkaqe për të cilat ndalohet diskriminimi gjatë marrjes në punë apo profesionit. Ky Kod njih shpërndarjen apo zhvendosjen e barrës së provës kur trajtohen çështjet për diskriminim në disa aspekte të marrëdhënjeve të punësimit.** Në Kodin e Punës, neni 115, pika 3 (Barazi në shpërblim midis sekseve) parashikohet se “kur punëmarrësi parashtron të dhëna serioze që lënë të kuptojnë ekzistencën e një diskriminimi, punëdhënësi është i detyruar të provojë të kundërtën”. Gjithashtu në nenin 105/a, pika 2 (Mbrojtja e punësimit të gruas) parashikohet se “në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, kur gruaja është në punë gjatë periudhës së shtatëzansisë ose është kthyer në punë pas lindjes së fëmijës, sipas nenit 30 të këtij Kodi, i takon punëdhënësit të vërtetojë se shkak i pushimit nga puna nuk ka qenë shtatëzania ose lindja e fëmijës”.

Kodi i Procedurave Administrative parashikon parimin e barazisë dhe antidiskriminimit si një ndër parimet e përgjithshme që duhet të mbështetet veprimtaria e administratës publike. Neni 11 i KPA thekson se “Në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohe apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore”. **Pra KPA nuk parashikon shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si shkak të mbrojtjes nga sjelljet diskriminuese.**

Në Shqipëri deri në vitin 2001, homoseksualizmi është konsideruar vepër penale e parashikuar nga neni 116 i Kodit Penal. Homoseksualizmi është dekriminalizuar në vitin 2001, me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal, sipas ligjit nr. 8733, datë 24.01.2001. Ligj nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka realizuar disa shtesa/riformulime për të cilat Komisioneri ka dhënë rekomandimet përkatëse.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka evidentuar se duhet ndërhyrë në kuadrin ligjor ekzistues për të realizuar një përafrim të legjislacionit ekzistues me Ligjin Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, gjë që do të rrisë garancitë ligjore edhe për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT. Edhe në Raport Progresin e BE-së për Shqipërinë 2013 thuhet shprehimisht: Ekziston legjislacioni në fushën e politikave anti-diskriminuese, p.sh. lidhur me të drejtat e personave lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI). Autoritetet shqiptare duhet të zbatojnë edhe legjislacionin ekzistues edhe të hartojnë legjislacion të ri në fushën e anti-diskriminimit¹³.

¹² Kodi i Punës i RSH-së në nenin 9 ndalon “çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit”. Ky Kod parashikon si shkaqe diskriminimi “racën, ngjyrën, seksin, moshën, fenë, bindjen politike, kombësinë, origjinën shoqërore, lidhjen familjare, të meta fizike ose mendore që cenon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim”.

¹³ Progres Raporti 2013 Për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillin, fq 10

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes Shkresës me nr Prot 175, datë 07.03.2013 “Për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”:

- Ka vlerësuar si pozitive në projekt -ligj përfshirjen në riformulimin që i është bërë gjermës “j” të nenit 50 të Kodit Penal, duke parashikuar si rrethana rënduese edhe shkaqet e tjera të parashikuara edhe në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁴.
- Ka rekomanduar që neni 84/a të Kodit Penal, të riformulohet ose të shtohet një nen tjetër me qëllim parashikimin si figurë të veçantë vepre penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit (**nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal**).
- Ka rekomanduar të riformulohen ose të shtohen nene të reja pas nenit 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik” dhe 119/b “Fyerja me motive racizmi ose ksenofomie nëpërmjet sistemit kompjuterik” në mënyrë që të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit (**nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal**).
- Ka rekomanduar në seksionin e III-të të Kodit penal, të titulluar “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, pas nenit 265 “Nxitja e urrjetjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, të shtohet një nen për të kriminalizuar nxitjen e urrjetjes për shkak të orientimit seksual¹⁵ dhe identitetit të tyre gjinor (**nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal**).
- Ka rekomanduar neni 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve” të riformulohet në mënyrë që të përfshihen edhe shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” duke përfshirë këtu orientimin seksual dhe identitetin gjinor të personit, duke garantuar një mbrojtje më të gjerë të personave ndaj shkaqeve diskriminuese, për të cilat një punonjës me funksion shtetëror apo në shërbim publik mund të bëjë dallime ndaj shtetasve duke shkelur në këtë mënyrë parimin e barazisë¹⁶.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, (me shkresën nr. 360 Prot, datë 14.09.2012), ka rekomanduar ndryshimet e mëposhtme:

- Në përkufizimin që Kodi i Punës i jep diskriminimit është propozuar të shtohen shkaqet e diskriminimit në përputhje me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Të shtohen edhe format e tjera të diskriminimit si: “Udhëzimi për të diskriminuar”; “Shqetësimi”; “Viktimizimi”; “Diskriminimi për Shkak të shoqërimit”; si dhe “Mohimi i Përshtatjes së Arsyeshme”. Duhet të shtohen edhe format e tjera të diskriminimit që

¹⁴ Realizuar përmes Ligj nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

¹⁵ Realizuar përmes Ligj nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

¹⁶ Realizuar përmes Ligj nr. 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

parashikon ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ose duhet bërë ndonjë reference tek ky ligj”.

Komisioneri përmes Shkresës me Nr 691/1Prot, datë 30.12.2013 ka bërë disa rekomandime lidhur me projekt-ligjin “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si më poshtë:

- Meqënëse në riformulimin që i është bërë parimeve kryesore që udhëheqin Kodin e Procedurave Administrative, nuk gjen më pasqyrim parimi i barazisë. Rekomandojmë: **Riformulimin e nenit 5 të projektligjit ose shtimin e një neni të veçantë**, ku të formulohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike. Shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Në kuadër të procesit të integritit europian dhe përafrimit të legjislacionit me *acqui communautaire*, në lidhje me barrën e provës kërkohet që për rastet kur kërkesa e paraqitur para organeve publike, por jo vetëm (subjekte private në fushën e punësimit, subjekte private që ofrojnë të mira dhe shërbime për publikun), ka të bëjë me cënimin e parimit të barazisë, kërkohet që barra e provës të zhvendoset. Sa më sipër dhe me qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm propozojmë: **Shtimin e një neni në Titullin V, Kreu 4, Seksioni 2, që të rregullojë barrën e provës në çështjet e diskriminimit, me përmbajtje si vijon:** “Në rastet kur palët e interesuara pretendojnë se parimi i trajtimit të barabartë është shkelur, ato kanë detyrimin të sjellin fakte dhe prova nga të cilat mund të prezumohet se ka patur diskriminim, atëherë do të jetë detyrim i palës tjetër të provojë se nuk ka patur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”.

2. Konteksti social, perceptimet dhe qëndrimet ndaj komunitetit LGBTI.

Në mënyrë që të garantohet sa më mirë mbrojtja nga diskriminimi, kemi nevojë që të dimë situatën e diskriminimit dhe efektet e implementimit të instrumenteve ligjorë në vend. Në Shqipëri nuk ka një sistem unik dhe të standardizuar të regjistrimit, mbledhjes dhe analizimit të të dhënave mbi diskriminimin. Rrjedhimisht, është e vështirë të bëhet një pasqyrim objektiv i mbrojtjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit apo të përcaktosh llojet dhe shkaqet. Ky material është bazuar në burime të ndryshme të disponueshme, raportet e organizmave ndërkombëtare, OJF-ve dhe aktivitetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Diskriminimi ndaj personave LGBT lidhet me paraqitjen e tyre të jashtme ose sjelljen. Personat që nuk sillen ose nuk jetojnë sipas “normave” shoqërore, janë shpesh viktimat e diskriminimit në të gjitha mjediset; familje, shkollë, pune, rrugë dhe mjedisë publike.

Për të arritur një pasqyrim sa më të saktë e të plotë do të trajtojmë problematikat e mëposhtme:

2.1. Mbrojtja nga veprimet e dhunshme ndaj komunitetit LGBT.

Anëtarë të komunitetit bëhen viktimat të incidenteve me bazë urrejtje (në vende publike dhe familje). Ka raste që ndeshen me ngacmime nga policia edhe kur në fakt kërkohet mbrojtja apo shërbimi i tyre. Janë verifikuar raporte për ngacmime të personave LGBT dhe sjellje brutale nga ana e policëve kundër punonjësve transgjigjorë të seksit¹⁷. Komisioneri ka identifikuar disa raste të ushtrimit të dhunës nga familjarët apo të ushtrimit të dhunës verbale dhe fizike nga persona të paidentifikuar. Gjithashtu janë deklaruar pranë zyrës së Komisionerit ankesa për mosofrimin e shërbimeve të kërkuara nga oficerët e policisë nga ana e përfaqësuesve të komunitetit ose kryerja e tyre vetëm pas ndërhyrjeve të OJF-ve që ofrojnë ndihmë për këta persona. Duam të theksojmë se komuniteti transgjigjor, paraqet problematika të mëdha që kanë të bëjnë me strehimin, punësimin, arsimin e sidomos me kujdesin shëndetsor¹⁸. Këto kanë sjellë edhe mosreferimin e sjelljeve diskriminuuese.

Krimet për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nuk reflektohen si krime homofobike në statistikat zyrtare; vetëm në Maj 2013 është parashikuar shprehimisht si vepër penale (neni 265) apo si rrethanë rënduese (neni 50/j). Por, *“një minimum të dhënash statistikore duhet të mbliidhet dhe të publikohet mbi numrin e incidenteve që përbëjnë krimin e urrejtjes të raportuara nga publiku dhe të regjistruara nga autoritetete, numri i dënimeve, shkakun për të cilin sjellja është konsideruar diskriminim”*¹⁹.

Jo në pak raste debati mbi të drejtat e komunitetit LGBT është shoqëruar me debate deri në përdorimin e “gjuhës së urrejtjes”. Theksojmë se “gjuha e urrejtjes” kundër personave gay lesbike, biseksualë dhe transeksualë (komuniteti LGBT), ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, ashtu edhe nëpërmjet internetit, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj njerëzve LGBT²⁰. Vlerësimi nëse shprehje apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “gjuhë e urrejtjes”, duhet të bëhet në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të KEDNJ. Një “gjuhë urrejtje” e tillë duhet të ndalohet dhe publikisht të kundërshtohet kurdo që ndodh. Gjithë masat duhet të

¹⁷ Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane.

¹⁸ Komisioneri për të Drejtat e Njeriut ka theksuar mungesën e të dhënave për situatën e personave transeksual. SHIH: Komisioneri për të Drejtat e Njeriut “Të drejtat e njeriut dhe identiteti gjinor”, 29 korrik 2009.

¹⁹ European Union Agency for Fundamental Rights “Making hate crime visible in the European Union: acknowledging victims’ rights”, Luxembourg, 2012, fq 11.

²⁰ Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: “Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura për të luftuar të gjitha format e shprehjes, duke përfshirë, në media dhe në internet, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se ka gjasa për të prodhuar efektin e nxitjes, përhapjen ose nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave gay lesbike, biseksualë dhe transeksualë.

respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës²¹.

Sjellim në vëmendje qëndrimet fyese dhe denigruese të përdorura nga dy përfaqësues të një partie politike (njëri Zëvendës Ministri i Mbrojtjes) ndaj komunitetit LGBT. Në mbrojtje të komunitetit LGBT (mbas këtyre deklaratave denigruese), ka pasur deklarata nga Kryeministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Komisioneri shqyrtoi dy çështje të nisura kryesisht dhe për njërin nga të cilat u bë ankesë nga dy OJF: Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT dhe Të Bashkuar PRO kauzës LGBT. Në njërin çështje nuk u arrit të konkludohej për sjellje diskriminuese. Shoqatat që paraqitën ankesën bënë gjithashtu një denoncim në prokurori për nxitje të urrejtjes për shkak të orientimit seksual, i cili nuk u pranua nga Prokuroria, me argumentin se kjo nuk është një vepër penale e parashikuar nga Kodi Penal i R.SH. *Nisur nga kjo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadrin e ndryshimeve në Kodin Penal propozoi: Për të shtuar një artikull të ri pas nenit 265 “nxitje të urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, më qëllim për të kriminalizuar nxitjen e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ky propozim është pasqyruar pjesërisht në ndryshimet e Kodit Penal të RSH të miratuar në maj 2013.*

2.2. E drejta e organizimit, grumbullimit dhe liria e shprehjes.

Në Shqipëri nuk ka pengesa ligjore për komunitetin LGBT për tu organizuar në shoqata. Ekzistojnë katër OJF që përfaqësojnë komunitetin LGBT apo e kanë fokusuar aktivitetin e tyre në mbrojtje të këtij komuniteti. Realizimi i aktiviteteve dhe tubimeve nuk është penguar ligjërisht. Megjithatë ushtrimi i të drejtave të mësipërme ka njohur një zhvillim pozitiv. Ndërsa në 17 Maj 2010 në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë një grup përfaqësuesish të shoqërisë civile dolën së bashku në një konferencë për shtyp, në vitin 2012 dhe 2013 realizohen aktivitete në mjediset publike, me përfaqësues nga komuniteti LGBT, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura dhe qeveritare.

Fillimisht nuk janë krijuar mundësi reale për përfaqësuesit e këtij komuniteti për të bërë prezent para institucioneve opinionin dhe problematikat e këtij komuniteti.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e LGBT PRO/PINK Embassy, mbi pengimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të LGBT PRO/PINK Embassy, në seancën dëgjimore me grupet e interesit për ditën ndërkombëtare kundër SIDËS, organizuar nga Komisioni për Punën dhe Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, që është zhvilluar në datën 01.12.2010. LGBT PRO Shqipëri i ka dërguar një kërkesë zyrtare Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, ku i kërkon zhvillimin e një seance dëgjimore për shëndetin, mireqënien situatën dhe respektimin e të drejtave të personave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri. Në

²¹ Irma Baraku “*Mbi krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes*” në panelin “Pesë angazhimet konkrete që Qeveritë duhet të ndërmarrin në drejtim të përmirësimit të barazisë gjinore”.

Shih: http://ec.europa.eu/enlargement/taix/dyn/taix-vents/library/detail_en.jsp?EventID=53050

kërkesë nënvizohet edhe qëllimi i seancës sipas tyre: "...të diskutojnë në lidhje me shëndetin, mirëqënien, situatën dhe respektimin e të drejtave të personave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri." Seanca dëgjimore me grupet e interesit për ditën ndërkombëtare kundër sidës është realizuar me dt.30.11.2010. Rezulton se janë ftuar 2 (dy) përfaqësues të Institucionit të Shëndetit Publik, 1 (një) përfaqësues i Shoqatës së Talasemikëve dhe 1 (një) përfaqësues i Shoqatës së Njerëzve që jetojnë më HIV/AIDS.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik, rezulton se në Shqipëri predominon rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV/AIDS, në total 92% ku 81% i përket rrugës heteroseksuale dhe 11% homo-biseksuale. Këto të dhëna janë tepër domethënëse, sidomos për sa i përket përqindjes së konsiderueshme që zë transmetimi homo-bioseksual i HIV/AIDS.

Duke marrë parasysh involvimin direkt që përfaqësuesit e LGBT PRO/PINK Embassy kishin në këtë çështje, numrin e konsiderueshem të të infektuarve me HIV/AIDS, si pasojë e transmetimit homo-bioseksual të virusit, si dhe dëshirës që ata kishin shfaqur për pjesëmarrje në këtë seancë dëgjimore,

Duke patur në vëmendje se: Në nenin 36, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikohet: "*Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim*".

Mbështetur në nenin 32, gërma f) të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku parashikohet shprehimisht kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënieve sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit LGBT dhe institucioneve shtetërore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi REKOMANDOI :

1. Evitimin e deklaratave me nota diskriminuese në të ardhmen, të cilat ndikojnë në krijimin e një atmosfere të tensionuar dhe jo miqësore me komunitetin LGBT në Shqipëri.
2. Dhënien e të gjitha garancive të mundshme që mendimi, opinionit dhe fjala e tyre të dëgjohet vlerësohet dhe të merret në konsideratë, kur ata janë të involvuar në mënyrë direkte në çështje të caktuara për të ndihmuar këto komunitet të gëzojnë normalisht të drejtat dhe liritë e tyre.

Por gjatë këtyre viteve ky qëndrim ka ndryshuar. Në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë të datës 09.12.2013 përfaqësues të komunitetit LGBTI ishin pjesë e seancës dëgjimore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it. Iniciativa e përfaqësuesve të komunitetit apo të shoqërisë civile janë shoqëruar me debate të shumta "pro" dhe "kundër" duke kapërcyer në disa raste edhe kufijtë ligjorë të ushtrimit të lirisë së shprehjes nga ana e debatuesve.

2.3. Identiteti gjinor dhe jeta familjare.

2.3.a. A njihet partneriteti?

Legjislacioni shqiptar nuk njeh bashkëjetesën dhe martesën mes personave të të njëjtës gjini. Debatimi për këtë temë kanë qenë të forta. Jurisprudenca e GJEDNJ ka vënë theksin në të drejtën e personave LGBTI për të pasur një jetë familjare pa u diskriminuar për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor²².

2.3.b. A njihet e drejta për të ndryshuar gjininë?

Ligji nr.10 129/11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”, ndryshuar 2013, parashikon mundësinë e ‘Ndryshimit të të dhënës së aktit të lindjes’. Neni 44 thotë se “Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj”. Gjinia është përbërës i ndryshueshëm, por në këtë ligj nuk bëhet fjalë për procedurën e ndryshimit të gjinisë.

Gjatë implementimit të Projektit të Këshillit të Europës për LGBTI ekspertë të njohur të fushës së drejtësisë dhe të drejtave të njeriut kanë bërë një studim të legjislacionit ekzistues, Kodit të familjes dhe Ligji nr.10 129/11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”, duke dhënë rekomandimet përkatëse për nevojën e ndryshimeve legjislative.

2.4. Aksesimi në kujdesin shëndetësor, edukim dhe punësim.

Arsimi. Një nga risitë e ligjit “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 është se tek shkaqet e diskriminimit është përfshirë edhe “orientimi seksual” përveç shumë shkaqeve të tjera²³. Ky nen ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor para-universitar. Fëmijët dhe adoleshentët marrin “edukatë seksuale” vetëm në dy lëndë gjatë 12 viteve shkollor. Kurrikulat shkollorë vazhdojnë të mbeten shumë konservatore në lidhje me çështje të seksualitetit si e drejtë, si gjendje natyrore apo si çështje sociale. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë të patrajtuara në sistemin arsimor aktual. Raportime të shumta nga komuniteti tregojnë se jo vetëm nxënësit por edhe mësuesit janë shpesh diskriminues ndaj personave LGBTI. Shpesh ndodh që ata bëhen legjitimues të sjelljeve homofobike dhe diskriminuese ndaj fëmijëve apo adoleshentëve LGBTI²⁴. Mbetet problematike trajtimi i komunitetit në ambjentet e institucioneve mësimore dhe shfaqjet e bullizmit në këto ambjente. Komisioneri ka zhvilluar një monitorim mbi njohjen e ligjit nga mësuesit dhe nxënësit, ku është evidentuar edhe orientimi seksual si një ndër shkaqet e diskriminimit në institucionet arsimore²⁵. Nga ky monitorim, i cili u realizua në formën e anketimit, u evidentua se ndër shkaqet kryesore të diskriminimit që nxënësit rendisnin ishte dhe orientimi seksual me 17%. Kjo përqindje doli nga anketimi i zhvilluar në 6 shkolla të arsimit parauniversitar në 6 bashki.

²² Vallianatos and Others v. Greece [GC] - [29381/09](#) and [32684/09](#), 7.11.2013.

²³ Neni 5/ 1 i Ligjit nr.69/2012 “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë”

²⁴ Marrë nga publikimi i PINK Embassy/ LGBT Pro Albania. Financuar nga Programi MATRA, Ministria e jashtme e Mbretërisë së Hollandës.

²⁵ Shih në faqet 22,23 të këtij raporti.

Një ndër prioritetet e BE-së është dekriminalizimi i marrëdhënieve seksuale mes personave të të njëjtit seks. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) që prej vitit 1990 e ka hequr homoseksualitetin nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me Shëndetin. Megjithatë personat me orientim seksual të ndryshëm janë konsideruar dhe vazhdojnë të konsiderohen akoma me pa të drejtë si persona të sëmurë. Shprehje se “homoseksualizmi është sëmundje” janë të pabazuara dhe dezinformojnë opinion publik. Për më tepër në disa tekste shkollore homoseksualizmi trajtohet si sëmundje. Nuk kemi një studim mbi diskriminimin ndaj komunitetit LGBT në përmbajtjen e programeve mësimore të të gjitha niveleve, por as të përfshirjes në këto programe të informacionit mbi këtë komunitet.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar një çështje mbi përmbajtjen diskriminuese të një prej literaturave të përdorura nga dy fakultete në zhvillimin e një moduli të kurrikulës universitare²⁶.

Kujdesi shëndetësor. Komuniteti LGBTI, sidomos personat transgjnorë, vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe të kenë vështirësi për të aksesuar në shërbimet sociale dhe shëndetësore²⁷. Gjendja shëndetësore e personave LGBTI (mendore dhe fizike) mbetet e panjohur për shkak se pjesa më e madhe e komunitetit refuzon të pranojë publikisht orientimin seksual. Të vetmet të dhëna janë mbi MSM në kuadër të luftës kundër HIV/AIDS. Institucionet europiane theksojnë si domosdoshmëri që në planet mbi shëndetësinë të përfshihen masa mbi studime për shëndetësinë, kurrikula trajnimi dhe politika shëndetësore të cilat marrin në konsiderat personat LGBT dhe nevojat e tyre²⁸.

Punësimi

Nuk ka raportime apo statistika për gjendjen e personave LGBT me punësimin. Aktualisht politikat e diversitetit nuk zbatohen për çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjnor. Institucionet europiane theksojnë rëndësinë e ndërgjegjësimit me fokus të drejtat e komunitetit LGBTI në kurset e trajnimit profesional, mbështetjen e sindikatave dhe organizatave të punëmarrësve në përpjekjet e tyre për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në punësim, hartimin dhe zbatimin e politikave të trajtimit të barabartë përmes adaptimit të kodit të sjelljes, ndarjes së praktikave të mira në mbështetje të komunitetit. Aktualisht asnjë institucion apo biznes nuk dihet të ketë hartuar politika specifike në të mirë të personave LGBT²⁹.

Është e rëndësishme që në strategjitë për barazinë mes burrave dhe grave që kontribuojnë për të luftuar stereotipet dhe diskriminimin dhe dhunën me bazë gjnore, të përfshihen edhe programet që luftojnë stereotipet dhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjnor³⁰. Komisioneri ka përgatitur me mbështetjen e UN Women “Guidë burimore për mbrojtjen nga diskriminimi gjnor në sektorin ekonomik”. Qëllimi i saj është të ofrojë sa më shumë informacione praktike për të kuptuar sjelljet diskriminuese, format e shfaqjes së tyre, rregullimet ligjore që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi, adresimin e diskriminimit gjnor, mekanizmat

²⁶ Vendimi nr.11, datë 08.02.2013

²⁷ Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin Europian dhe Këshillin.

²⁸ European Union Agency for Fundamental Rights “EU LGBT survey European Union lesbian, gay, bisexual and transgender survey”, Luxembourg, 2013, fq 13.

²⁹ www.pinkembassy.al/publikime

³⁰ European Union Agency for Fundamental Rights “EU LGBT survey European Union lesbian, gay, bisexual and transgender survey”, Luxembourg, 2013, fq 10.

ligjorë të mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe instrumentat e monitorimit dhe raportimit të sjelljeve diskriminuese me bazë gjinore në sektorin ekonomik³¹. Nuk ka statistika që të tregojnë nëse personat LGBT e deklarojnë hapur orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor në mjediset e punës. Raste individuale janë të suksesshme por edhe negative. Komuniteti LGBTI raporton sjellje diskriminuese në mjediset e punës. OJF-të kanë raportuar disa herë për diskriminim dhe humbje të vendeve të punës për shkak të orientimit seksual.

Të mirat dhe shërbimet

Vëmë re se ka homofobi jo vetëm në ambientet shkollore apo të punës, por edhe në ofrimin e shërbimeve. Duhet vënë theksi tek shërbimet sidomos të shërbimi mjekësor ku shpeshherë ky shërbim u është mohuar personave LGBT, duke qenë një diskriminim i hapur ndaj këtij komuniteti. Diskriminimi ndaj personave LGBT lidhet me paraqitjen e tyre të jashtme ose sjelljen. Personat që nuk sillen ose nuk jetojnë sipas “normave” shoqërore, janë shpesh viktime të diskriminimit në të gjitha mjediset; familje, shkolle, pune, rrugë dhe mjedise publike. Komuniteti ka raportuar për sjellje diskriminuese në njësi tregtare shërbimesh, përmes qëndrimeve armiqësore apo mohimit të ofrimit të shërbimit³².

Komisioneri (me Shkresën Nr. 367 Prot., datë 01.07.2013) sjell në vëmendje se Ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës jo vetëm që të eliminojë parashikimet diskriminuese ekzistuese në programet mësimore të të gjitha niveleve, por edhe të përfshijë në to informacion për ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese. Bazuar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis dy institucioneve tona, një nga angazhimet është pikërisht bashkëpunimi në drejtim të eliminimit të parashikimeve diskriminuese që mund të ekzistojnë në tekstet e ndryshme që përdoren në sistemin arsimor.

Për sa më sipër Komisioneri Rekomandoi:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publike, gjatë procesit të miratimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të mbajnë në vëmendje ndryshimet në tekstin “Mjekësia Ligjore”.
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të marrë të gjitha masat për të garantuar që të gjitha institucionet e arsimit të lartë private dhe publike, gjatë procesit të miratimit të programeve dhe planeve mësimore, si dhe literaturës që do të përdoret, të evitojnë përfshirjen e teksteve dhe literaturës, që kanë në përmbajtjen e tyre parashikime dhe koncepte diskriminuese.
- Të sillen në kujtesë të drejtuesve të institucioneve arsimore publike dhe private, detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

KMD (me shkresën nr. 461 Prot, datë 05.09.2013) u ka dërguar “rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin të vitit shkollor 2013-2014 në sistemin arsimor para-universitar”, të gjitha Drejtorive Rajonale Arsimore të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës që ndër të tjera: *Të monitorojnë në*

³¹ Shih: http://kmd.al/skedaret/1393580529-Guida_Burimore.pdf

³² Vendimi nr.5, date 23.01.2014 (çështja ka filluar në vitin 2013).

mënyrë të vazhdueshme masat që marrin drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla, dhe mënyrën e trajtimit të sjelljeve dhe qëndrimeve homofobike, stigmatizuese dhe diskriminuese ndaj nxënësve që i përkasin komunitetit LGBT.

3. Adresimi i çështjeve të diskriminimit me synim rritjen e numrit të ankesave.

Gjatë vitit 2012- 2013 pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë trajtuar 12 ankesa dhe çështje ex-officio ku pretendohet diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Vlen të theksohet fakti se bashkëpunimi me OJF-të ka qënë mjaft i efektshëm për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. Në disa raste informacioni i sjellë nga organizatat e shoqërisë civile ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për iniciimin kryesisht të çështjeve. Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2013 përveç ankesave individuale, janë paraqitur edhe 17 ankesa nga organizata me interesa legjitim. Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e komunitetit LGBT.

Pra, shihet që numri i ankesave mbetet i ulët në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave për shkaqet e tjera (12 nga 295 çështje të trajtuara gjatë këtyre viteve). Nga këto 12 çështje KMD ka konstatuar diskriminimin në 7 çështje dhe ka dhënë 3 sanksione me gjobë.

Së pari: Trajtimi i homoseksualizmit si një sëmundje dhe shpërndarja e informacionit të gabuar përmes teksteve universitare.

Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri përmes një komunikimi për shtyp dhe një ankesë dërguar KMD kërkon: heqjen nga tregu të të gjitha teksteve të cilat diskriminojnë komunitetin LGBT dhe përditësimin e të gjitha teksteve akademike, përfshirë këtu tekstin "Mjekësia Ligjore" të përdorur nga Fakulteti i Mjekësisë dhe fakulteti i Drejtësisë. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur:** Përmbajtja e librit "Mjekësia Ligjore", është diskriminuese; autorët që kanë prodhuar këtë material diskriminues duhet të modifikojë tekstin dhe nëse kjo nuk është e mundur duhet të heqin librin nga tregu dhe bibliotekat e të gjitha institucioneve brenda 60 ditësh; autorët e këtij teksti duhet të njoftojnë Komisionerin për veprimet që do të ndërmarin brenda 30 ditëve duke paraqitur gjithashtu një kopje të librit të rishikuar; nëse ky vendim nuk zbatohet, do të vazhdohet me vendosjen e sanksioneve të parashikuara me ligj. (Autorët dhe dekanët e fakulteteve kanë informuar Komisionerin për masat e ndërmarra prej tyre për zbatimin).

Së dyti: Asocimi i homoseksualitetit me sjellje devijante dhe kriminale.

Komisioneri ka shqyrtuar dy ankesa me pretendime pothuajse të njëjta. Njëra e iniciuar me nga Komisioneri kundër shtetasit E.S në lidhje me deklaratimet në median vizive që identifikonin pedofilinë me orientimin seksual. Ankesa tjetër është bërë nga dy organizata me interesa legjitimë Ambasada PINK dhe organizata Pro LGBT Shqipëri të cilat pretendonin se shkrimi i botuar nga shtetasi A.L në një gazetë të përditshme, ka përmbajtje të hapur diskriminuese, homofobike dhe keq informuese ndaj komunitetit LGBT në Shqipëri.

Në të dy këto ankesa Komisioneri ka vlerësuar se E.S dhe A.L kanë përdorur shprehje në adresë të

komunitetit LGBT, të cilat krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë-informuar në lidhje me çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa dhe ndjenja urrejtjeje ndaj këtij komuniteti. Komisioneri ka vlerësuar se shprehjet e përdorura nga E.S dhe A.L, janë flagrante dhe përcjellin një gjuhë të urrejtjes të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Komisioneri ka konstatuar se shprehjet e përdorura nga E.S dhe A.L janë diskriminuese, pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çënojnë sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Gjithashtu, në këtë vendim Komisioneri vendosi detyrimin e E.S dhe A.L si persona të cilët kanë konsumuar sjellje diskriminuese të kërkojnë publikisht ndjesë si dhe të evitojnë në të ardhmen përdorimin e gjuhës që nxit urrejtje.

Duke qenë se në përgjigje të vendimit, subjektet nuk kanë reaguar, Komisioneri, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka vendosur masën administrative me gjobë, në vlerat 20.000 lekë për E.S dhe 10.000 lekë për A.L.

Së treti: tendenca e trajtimit të homoseksualitetit si një temë që lidhet me lajme skandaloze

Transmetimi i informacionit mbi veprën penale, duke e lidhur me karakteristika personale të individit (orientimi seksual) që prezumohet apo ka kryer veprën penale edhe kur kjo karakteristikë nuk përcakton cilësimin e veprës penale si të tillë, vendos një praktikë që në mënyrë të tërthortë diskriminon individët apo komunitetet për shkak të këtyre karakteristikave.

Për një adresim sa më të kualifikuar të çështjeve diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI Komisioneri është përfshirë në një sërë veprimtarish për rritjen e kapaciteteve të stafit:

- ✓ Në zbatim të projektit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me temë “Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore”, implementuar në bashkëpunim me PNUD, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2013, KMD është asistuar në veprimtarinë e tij nga një Grup Ekspertësh (i përbërë nga 4 studiues të së drejtës dhe një ekspert ndërkombëtar, me eksperiencë në institucionet e barazisë) në marrjen e vendimeve dhe hartimin e opinioneve legjislative.
- ✓ Gjithashtu, po në kuadër të këtij projekti, është pregatitur për botim një përmbledhje me Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë si dhe Institucioneve të Barazisë të vendeve të BE-së, të cilat janë përkthyer në shqip.
- ✓ Me datë 7 qershor 2013, dy përfaqësues nga Zyra e KMD-se si dhe Komisioneri morën pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë “Zbatimi i urdhrave të mbrojtjes në kuadrin e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje”, organizuar në kuadër të projektit “Parandalimi dhe luftimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, në kuadrin e drejtësisë gjinore”, të Shkollës së Magjistraturës, mbështetur nga UNDP.
- ✓ Në datat 18-22 nëntor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në vizitën studimore të zhvilluar në Suedi pranë Institutit Suedez. Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte njohja e delegacionit të Ballkanit me mënyrën e trajtimit të çështjeve LGBT nga

Suedia, njohja me institucionet që merren me këto çështje si dhe mënyra e organizimit të paradës së përvitshme të komunitetit LGBT.

- ✓ Në datat 6-7 qershor 2013, dy punonjës të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në workshop-in me temë “*Mënyrat efektive për të luftuar diskriminimin në Ballkanin Perëndimor*”, të organizuar nga Civil Rights Defenders.
- ✓ Në datën 17 Shtator 2013, Këshilltari dhe një punonjës nga Zyra e KMD-së morën pjesë në workshop-in me temë “*Çështjet e personave transgjiniore dhe Interseks në Shqipëri*”, organizuar nga Aleanca LGBT dhe Pro LGBTI. Me datë 1 nëntor 2013, një përfaqësues i Zyrës së KMD mori pjesë në seminarin “*Zhvillimi i Litigimit Strategjik për çështjet e personave LGBTI*”.
- ✓ Në datat 20-21 nëntor 2013, dy përfaqësues të Zyrës së KMD morën pjesë në Seminarin e zhvilluar nga Avokati i Popullit me temë “*Përdorimi i Treguesve për të zbatuar dhe vlerësuar të drejtat e Njeriut në Shqipëri*”.

4. Hartimi i politikave dhe strategjive dhe adresimi i tyre nga institucioni i barazisë dhe mosdiskriminimit.

Shqipëria nuk ka një strategji për mbrojtjen nga diskriminimi, por ka ndërmarrë masa konkrete me synim mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT dhe disa komuniteteve të tjera vunerabël.

- *Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e “Planit të Masave për mosdiskriminimin për shkak të Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjिनор 2012-2014”, duke dhënë kontributin e tij në propozimet për ndryshimet në kuadrin ligjor dhe për politikat anti-diskriminim në punësim, arsim dhe në fushën e të mira dhe shërbimeve. Disa nga masat e parashikuara në këtë plan, janë: trajnimi i administratës publike në qendër dhe në qeverisjen vendore me konceptet e reja dhe parimet e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi; organizimi i fushatave ndërgjegjësuere/sensibilizuese, publikimeve vjetore, botime, fletëpalosje, praktika të suksesshme kundër diskriminimit; marrja e masave konkrete nga institucionet publike dhe bizneset/aktivitetet private për garantimin e barazisë në bazë të ligjit anti-diskriminim; trajnime të specialisteve të zyrave të punësimit dhe i stafeve mësimore për çështjet LGBT.*
- *Strategjia e KMD përcakton komunitetin LGBT si një ndër komunitetet më të riskuara e sidomos si një ndër grupet për të cilat kërkoht realizimi i një sërë përmirësimesh ligjore, rishik kurikulash dhe ndërgjegjësim i shoqërisë për të drejtat e tyre*³³.

5. Promovimi i të drejtave të komunitetit dhe aspekti komunikativ.

Në promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI ka rëndësi të veçantë qëndrimi dhe mbështetja e opinionbërësve. “*Mbrojtja e hapur nga politikanët i bën personat LGBTI të jetojnë në mënyrë më të qetë jetën e tyre si të tillë. ...Merr rëndësi promovimi i një opinionit publik më të balancuar*

³³ Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, fq 36. Shih: <http://kmd.al/skedaret/RAPORTI-SHQIP-PER-PRINTIM.pdf>

mbi çështjet e LGBTI, duke lehtësuar përfshirjen në dialog të politikanëve, medias dhe komuniteteve fetare...”³⁴.

5.1. Media

Media ka shprehur një interes të veçantë ndaj çështjes LGBT dhe ka ndikuar ndjeshëm (pozitivisht & negativisht) në trajtimin e problematikave të komunitetit LGBT. Debati, diskutimi, apo edhe shkrime në gazeta të përditshme shqiptare për çështjet e të drejtave dhe lirive të personave me orientim seksual të ndryshëm janë të nevojshme në kushtet kur diskutimet për çështje të tilla ka qenë tabu. Mosnjohja në mënyrën e duhur të këtyre çështjeve bën që publiku të ketë një reagim të gabuar. Diskutime të tilla të mbështetura mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjyqimeve dhe stereotipave të gabuara të personave për shkak të orientimit seksual.

Shtetasi V.N ka paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit, pasi ndihet i diskriminuar nga disa media të shkruara dhe vizive për shkak të orientimit seksual, të cilat kanë transmetuar të plota të dhënat e tij personale. Në informacionin e dhënë në media personat e përfshirë në lajm janë etiketuar si homoseksualë si dhe është lidhur vepra e prostitucionit me karakteristikën personale të orientimit seksual. Z. V.N., deklaroi se për shkak të publikimit të emrit të tij në televizion dhe në gazeta, po refuzohet për tu marrë në punë, familjarët nuk e duan si dhe është sharë dhe ofenduar në mjediset e komisarariatit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KMD është shprehur se transmetimi i informacionit mbi veprën penale, duke e lidhur me karakteristika personale të individit që prezumohet apo ka kryer veprën penale edhe kur kjo karakteristikë nuk përcakton cilësimin e veprës penale, vendos një praktikë që në mënyrë të tërthortë diskriminon individët apo komunitetet për shkak të këtyre karakteristikave.

Komisioneri ka rekomanduar që mediat të jenë më të kujdesshme dhe të përgjegjshme në publikimin e informacioneve duke kapërcyer tendencën e trajtimit të homoseksualitetit si një temë që lidhet me lajme skandaloze. Mediat duhet të marrin masa për mospublikimin e karakteristikave personale të individëve, që nuk kanë lidhje me cilësimin ligjor të veprës penale të kryer.

5.2. Organizimi i Konferencave dhe trajnimeve nga KMD dhe pjesmarrja në seminare e tryeza diskutimi.

Komisioneri si dhe stafi i KMD-së gjatë vitit 2013 ka organizuar dhe kanë marrë pjesë në rreth 35 seminare, konferenca dhe tryeza diskutimi mbi diskriminimin në fushën e punësimit, barazinë gjinore, ushtrimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, përfshirjen sociale të minoritetit rom në Shqipëri, të drejtat e komunitetit LGBTI. Nga këto do të veçonim:

³⁴Shih: European Union Agency for Fundamental Rights “EU LGBT survey European Union lesbian, gay, bisexual and transgender survey”, Luxembourg, 2013, fq 10 dhe European Union Agency for Fundamental Rights “Homophobia, transphobia and discrimination on grounds of sexual orientation and gender identity in the EU Member States”, Luxembourg, 2013, fq 10.

Në datën 18 mars 2013, Komisioneri mori pjesë në Konferencën Rajonale **“Të drejtat e Komunitetit LGBT në Ballkanin Perëndimor- Arritje dhe Sfidat”**, të organizuar nga Ambasada PINK në bashkëpunim me COC Hollandë dhe me mbështetjen e Programit MATRA të Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulta. Në këtë konferencë Komisioneri pasqyroi sfidat e diskriminimit të Komunitetit LGBTI në Shqipëri.

Në datën 16 Maj 2013 u organizua tryeza e rrumbullakët: **“Shqipëria kundër homofobisë: LGBTI përballë politikës, medias, të rinjve dhe masave kundër diskriminimit”**, realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit. Në këtë takim, Komisioneri mbajti fjalën përshëndetëse me temë: **“Të drejtat e komunitetit LGBTI si të drejta themelore të njeriut”**.

Në datën 17 maj 2013, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, KMD ka qenë pjesë e organizimit të **“Panairit të Diversitetit 2013”**. KMD kishte standin e tij në këtë panair. KMD ka marrë pjesë në takimet konsultative për organizimin e këtij Panairi, duke dhënë kontributin e tij në përgatitjen e fletëpalosjeve dhe logos së Panairit të Diversitetit.

Me datë 17-19 Qershor 2013, Komisioneri mori pjesë në **workshop rajonal me temë: “Të drejtat njerëzore të Komunitetit LGBTI, Trajtimi i Barabartë dhe Lufta kundër Diskriminimit”**, organizuar në Beograd, Serbi, nga **“People 2 People”**, Program i Komisionit Europian në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore të Minoriteteve në Serbi. Komisioneri mbajti një referim **“Mbi krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes”**. Prezantimet e Komisioneres ndodhen në website TaieX: http://ec.europa.eu/enlargement/taieX/dyn/taieX-events/library/detail_en.jsp?EventID=53050

Me datë 2 tetor 2013 në ambjentet e Qendrës Aleanca kundër Diskriminimit LGBTI u zhvillua një workshop me komunitetin LGBTI. Në këtë workshop mori pjesë një përfaqësuese e Zyrës së KMD me qëllim prezantimin e mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi, rolin e KMD-së dhe modelet pozitive, mënyrat e ankimit, procedurat për shqyrtimin e rasteve etj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi, me datë 7 nëntor 2013, **Konferencën “Mbrojtja nga diskriminimi: Modelet pozitive dhe sfidat”**. Konferenca kishte për qëllim të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile, mediave dhe organizmave ndërkombëtarë ndaj të drejtës për mbrojtje nga diskriminimi, arritjeve dhe sfidave në këtë fushë. Konferenca u realizua përmes tryezave të veçanta të diskutimit për mbrojtjen nga diskriminimi të grupeve vulnerabël, pjesë të të cilave ishin grupet e interesit, përfaqësues të OJF-ve që kanë në objekt mbrojtjen e të drejtave të këtyre target grupeve si dhe përfaqësues të KMD-së. Janë ndarë gjashtë grupe pune: për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve, minoriteteve, komunitetit LGBTI, personave me aftësi të kufizuar dhe një tryezë ka diskutuar lidhur me sfidat e zbatimit të ligjit 10 221/2010 **“Për mbrojtjen nga diskriminimi”**.

Në përfundim të Konferencës u evidentuan si **modele pozitive**:

Bashkëpunimi pozitiv me OJF-të për referimin e rasteve të diskriminimit;
Vendime që krijojnë modele pozitive të trajtimit të çështjeve të diskriminimit;

Bashkëpunimi pozitiv me OJF-të për trajnimin e institucioneve vendore, stafeve mësimore e Zyrrave të Punësimit për trajtimin e çështjeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit;
Informacioni që përmban elemente që nxisin sjelljet diskriminuese trajtohen ex-officio;
Kryerja e monitorimeve në sistemin arsimor dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Grupi i punës për mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit LGBTI, doli me këto **përfundime dhe rekomandime**:

Vendimet e Komisionerit të jenë më të dukshme, të bëhen më shumë publike.
Problem mbetet diskriminimi i komunitetit LGBTI në mjediset publike.
Përforcimi i masave administrative ose gjobë ekstreme.
Vështirësia për adresimin e rasteve.
Problemi, deri ku shkon liria e fjalës.
Komuniteti LGBTI e ka të vështirë të nxjerri problematikat.
Duhet një monitorim sidomos tek sektori privat.

Ka promovuar dialogun social kundër sjelljeve diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI. Prezantimi i rasteve të fundit të diskriminimit për shkak të orientimit seksual në televizione Kombëtare dhe lokale si: “News 24” dhe emisioni “Top show” në televizionin “Top Channel”, “Ora News”, “Channel One”, Radio Albania News etj.

Ka botuar disa shkrime në shtypin e shkruar: “Mes lirisë së shprehjes dhe “gjuhës së urrejtjes” në Gazeta Mapo, dt.18.05.2012; “Respektimi i të drejtave të Komunitetit LGBTI: Arritje dhe Sfida” të shkruar në “Gazeta Shqiptare” me dt. 14.12.2012; “Të drejtat e komunitetit LGBTI, si të drejtat themelore të njeriut” me datë 16 maj 2013 në gazetën “Panorama”;

5.3. Publikimi i raporteve të veçanta dhe realizimi i monitorimeve.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa (f) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se Komisioneri ka kompetencë “*të publikojë raporte (...) për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*”, **KMD ka përgatitur këtë Raport të veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”**. Gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2014 ky raport do përgatitet për botim.

Ndërkohë KMD ka raportuar mbi situatën e komunitetit LGBT në raportet vjetore³⁵ pranë Kuvendit të Shqipërisë apo në kuadrin e raportimeve pranë organizmave ndërkombëtarë si:

Me datë 8 mars 2013, KMD ka raportuar në takimin e IV^{të} të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në Bruksel. Në datat 17-18 Prill 2013 KMD ka raportuar në Takimin e V^{të} të Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë BE-Shqipëri, i cili u zhvillua në Buksel. KMD ka raportuar pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të Raportit të Dytë Periodik Shqiptar për *Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, i cili u mor në shqyrtim në data 15-16 Korrik

³⁵ Raportet vjetore: 2011(fq 15, 40); 2012 (fq 16-17, 31-33, 59-60, 61); 2013(fq 15-19, 31-33, 51-52, 53-54)

2013, në Gjenevë. Komisioneri ka raportuar në kuadër të Takimit të pestë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për *Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale*, BE-Shqipëri, zhvilluar me datë 28-29 Tetor 2013, në Tiranë. Me datë 6 Nëntor 2013, Komisioneri ka raportuar në kuadër të zbatimit të *Paktit për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore* pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, në Gjenevë. Me datë 20 Nëntor 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, lidhur me plotësimin e Pyetësorëve në zbatim të Konventës së Këshillit të Evropës “*Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual dhe Shfrytëzimi Seksual*”. Me datë 27 Nëntor 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion Ministrisë së Punëve të Jashtme, lidhur me hartimin e Raportit Kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik (UPR) për të Drejtat e Njeriut.

5.4. Monitorimi në Arsim

Në vitin 2011 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konsideroi të nevojshme të zhvillojë një monitorim me fokus sjelljet diskriminuese në sistemin arsimor dhe nivelin e njohjes së ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Anketimet iu drejtuan konkretisht këtyre grup moshave:

1. Nxënësve të grup-moshës 12-15 vjeç dhe nxënësve të grup-moshës 16-18 vjeç
3. Mësuesve, psikologëve dhe drejtuesve të shkollave 9-vjeçare e të mesme.

Monitorimi u krye në Bashkitë: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe u shtri në 6 shkolla për secilën bashki. U bë e qartë nga ky monitori se 17% e nxënësve dhe 6% e mësuesve të anketuar rendisin orientimin seksual si shkak të diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dalë me rekomandime konkrete drejtuar institucioneve arsimore:

Drejtoria arsimore rajonale të marrë të gjitha masat për të përmbushur detyrimet që parashikon Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në kreun III të tij, duke u ndalur kryesisht në parashikimet ligjore të nenit 19 i cili parashikon:

Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:

- rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;
- lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit;
- të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dënjesisë;

- trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij;
- vendosja e masave disiplinore ndaj çdo personi që verifikohet të ketë kryer një veprim diskriminues kur një gjë e tillë është e përshtatshme, proporcionale dhe në përputhje me kompetencat e drejtorit.

5.5. Botimi dhe shpërndarja e broshurave informuese dhe manualeve trajnuese

Botimi i broshurave informuese me informacion të përgjithshëm mbi çështjet e diskriminimit dhe atyre me informacion specifik adresuar personave të komunitetit LGBT ka qënë një ndër mjetet për realizimin e objektivave të KMD-së për ndërgjegjësimin e këtij komuniteti mbi mundësitë për tu mbrojtur nga sjelljet diskriminuese. Përveç fletëpalosjeve e broshurave me informacion të përgjithshëm³⁶, e manualeve të ndryshme në fusha të veçanta si: arsim³⁷ dhe punësim apo për shkaqe të veçanta³⁸, apo adresuar aktorëve të ndryshëm si OJF³⁹, mësuesve dhe psikologëve të shkollave, veçojmë botimin e një fletëpalosjeje dhe një broshure informuese adresuar posaçërisht komunitetit LGBT:

- Broshura Informuese “*Si e Mbron Komunitetin LGBT Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”?*”, të cilat u hartuan me kontributin e përbashkët të Ambasadës Pink dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- “*Fletë informuese për zyrtarët publikë mbi çështjet LGBT*”, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Europës për LGBT.

REKOMANDIME

1. Përmirësimi i legjislacionit shqiptar për shmangien e diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në përputhje me aktet nderkombëtare, legjislacionin europian dhe Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

- Miratimi i propozimeve të bëra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, (me shkresën nr. 360 Prot, datë 14.09.2012).
- ✓ Për të adresuar parashikimet e bëra në Rekomandimin CM/Rec (2010) dhe për të garantuar të drejtën për siguri dhe mbrojtje nga dhuna të peronave për shkak të orinetimit seksual apo identitetit gjinor të tyre, propozojmë që : **pas nenit 84/a të**

³⁶ Janë botuar dhe shpërndarë 5000 fletëpalosjedhe broshura mbi LMD.

³⁷ 2500 kopje Broshurë Informative mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në fushën e arsimit (për sistemin arsimor par-universitar) dhe Manual Trajnimi për drejtuesit e Institucioneve Arsimore, për Psikologët e shkollave dhe punonjësit Social.

³⁸ Broshura Mbrojtja e pakicave në Shqipëri nga Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

³⁹ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komiteti Shqipëtar i Helsinkit me mbështetjen e Kooperacionit Zviceran në Shqipëri gjate vitit 2013 kanë pregatitur: “Manuali i Trajnimit: “Mbrojtja nga Diskriminimi – Manual Trajnimi për OJF-të”, botuar në vitin 2014.

Kodit Penal, të shtohet një nen tjetër me qëllim parashikimin si figurë të veçantë vepre penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.

- ✓ Për të adresuar parashikimet që bëhen në pjesën e I-rë të Rekomandimit CM/Rec (2010), gërma “B” “Fjalimet e urrejtjes”, ku parashikohet se : “Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikëve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin”, propozojmë që : **të riformulohen ose të shtohen nene të reja pas nenit 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik” dhe nenit 119/b “Fyerja me motive racizmi ose ksenofomie nëpërmjet sistemit kompjuterik” në mënyrë që të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.** Ekspertët e BE-së kanë theksuar gjithashtu nevojën e kryerjes së këtyre ndryshimeve dhe kanë rekomanduar që realizimi i tyre të përfshihet në Udhëzuesin për Prioritetin 5.
- ✓ Ashtu siç kemi theksuar dhe më lart Rekomandimi, kërkon me forcën ndalimin dhe dënimin publikisht të “gjuhës së urrejtjes” për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” e parashikon në nenin 1 të tij, **identitetin gjinor** si shkak të mbrojtur për të cilin ofron mbrojtje. Në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal në vitin 2013, dhe konkretisht ndryshimet në nenin 265, ky nen është riformuluar duke kriminalizuar nxitjen e urrejtjes dhe grindjeve vetëm për shkak të orientimit seksual, duke përfshirë këtu identitetin gjinor. **Propozojmë që neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, të riformulohet për të kriminalizuar edhe nxitjen e urrejtjes për shkak të identitetit gjinor.**
- ✓ **rekomandojmë gjithashtu heqjen e termit “marrëdhënie homoseksuale”** që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale.
- Miratimi i propozimeve të bëra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes Shkresës me Nr 691/1Prot, datë 30.12.2013 ka bërë disa rekomandime lidhur me projekt-ligjin “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- Miratimi i propozimeve të bëra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes Shkresës me nr Prot 175, datë 07.03.2013 “Për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

2. Është shumë e rëndësishme të bëhen kërkime dhe të mblidhen të dhëna për masat dhe praktikat diskriminuese, në veçanti kur bëhet fjalë për “krimet e urrejtjes” dhe “incidentet e motivuara nga urrejtja” për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke mbajtur parasysh të drejtën për respektimin e jetës private. Reflektimi në statistikën e policisë i krimeve për shkak të orientimit seksual.
3. Ndërgjegjësimi i shoqërisë në përgjithsi dhe grupeve të veçanta mbi të drejtat e komunitetit LGBT me synim nxitjen e debatit të papajtuësishëm me përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
4. Duhet të sigurohemi se viktimat e diskriminimit janë të informuar dhe mund të përdorin mjetet efektive ligjore.
5. Realizimi i sondazheve dhe monitorimeve mbi respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në fusha të ndryshme si arsim, punësim dhe shërbime. Përfshirja në kurrikulat/ekstra kurrikulat e shkollës e të drejtave të komunitetit LGBT si të drejta të njeriut; rishikimi i teksteve shkollë me përmbajtje diskriminuese; monitorime dhe studime për çështjet e diskriminimit/bulizmit/dhunës që përfshijnë edhe orientimin seksual etj.
6. Përfshirja e figurave publike (gazetarë, politikanë, arsimtarë...) në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT me synim nxitjen e modeleve pozitive.
7. Trajnimi i aktorëve të ndryshëm për trajtimin me barazi dhe mosdiskriminim të komunitetit si punonjësit e policisë, punonjësit e shëndetësisë, mësuesit e psikologët, nëpunësit e pushtetit vendor, gjyqëtarët.